



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:019475

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01538139

C.nr.466/11

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditësve A. (S) Q dhe N. (S.) Q që të dy nga Gjilani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shevqet Xhelili avokat nga Gjilani, kundër të paditurve: Sh. L nga Gjilani, Z. A nga Gjilani, F. I nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Ymer Huruglica, F. S nga Gjilani dhe M. B nga Gjilani, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm avokati Granit Sylaj nga Gjilani, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datën 10.02.2021, mori, ndërsa me datën 24.02 2021 e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. Q dhe N. Q që të dy nga Gjilani ndaj të paditurve: Sh. L., Z. A, F. I, F. S dhe M. B të gjithë nga Gjilani dhe

I. VËRTETOHET se paditësit: A. Q nga Gjilani, është pronar i njësisë kadastrale P-...parcelë, shfrytëzimi aktual bujqësore, arë në sipërfaqe prej 419 m² në vendin e quajtur ... e cila në ... në Gjilan evidentohet sipas çertifikatës së pronës me numer të lëndës 13401-2016 në emër të Z. (I)A. me 1/3 të pjesës ideale dhe Sh. (Sh)L, me 2/3, të pjesës ideale me këto permasa dhe kufij: nga ana veriore në gjërësi prej 15.70m, nga ana lindore në gjatësi prej 25.30m, nga ana jugore në gjërësi prej 17,40m, dhe nga ana perendimore në gjatësi prej 22.80m, gjithashtu është pronar i sipërfaqes prej 29m², pjesë e ngastrës kada.nr. P-..., me këto permasa dhe kufij: nga ana verore, në gjatësi prej 17,40 m, nga ana lindore në gjërësi prej 1,90 m, nga ana jugore në gjatësi prej 17,40 m, nga ana perendimore në gjërësi prej 1,90m, dhe nga ana jugore në gjatësi prej 17,40m dhe nga ana perendimore në gjërësi prej 1,50m, e cila në ... në Gjilan evidentohet sipas çertifikatës së pronës me numer të lëndës UL..., në emër të të paditurit F. I, ndërsa **paditësi N. Q.** është pronar i sipërfaqes prej 96m², pjesë e ngastrës kadastrale P-... me këto permasa dhe kufij: nga ana veriore, në gjatësi prej 20.10 m, nga ana perendimore në gjërësi prej 4,00m, e cila ...në Gjilan evidentohet sipas çertifikatës së pronës me nr të lëndës 13143-2016 në emër të F. /H./ S., gjithashtu është pronarë i sipërfaqes prej 26m², pjesë e ngastrës kat.P-... me këto masa dhe kufij: nga ana veriore në gjërësi prej 0.70 m, nga ana lindore në gjatësi prej 25,30m, nga ana jugore në gjërësi prej 1,40m dhe nga ana perendimore në gjatësi prej 25,30 m, e cila ... në Gjilan evidentohet sipas çertifikatës së pronës me numer të lëndës 13142-2016, në emër të të paditurës M. B. dhe **OBLIGOHEN** të paditurit Sh. L, Z. A, F. I, F. S dhe M. B të gjithë nga Gjilani, që këtë të drejtë t'ia pranojë paditësve dhe t'ia lejojnë të njëjtëve që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi ta regjistroj në ... në Gjilan, pronën e lartcekur në emër të tij.

II. OBLGOHEN të paditurit që paditësve t'ua kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,931€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Fillimisht paditësit A. Q dhe N. Q që të dy nga Gjilani, përmes të autorizuarit të tyre në këtë gjykatë mëdatë 15.07.2011, kanë paraqitur padi ndaj paditurve për vërtetimin e pronësisë. Paditësit në përmbajtjen e padisë kanë theksuar se, babai i tyre në vitin 1970 nga i padituri i parë Sh. L, kishte blerë një paluajtshmëri në sipërfaqe prej 5 ari me rrugë, e cila ngasgtrë tani mban numrin ... dhe ka një sipërfaqe prej 419 m² dhe e njehta evidentohet në të paditurve Shaban Latifi e Z. A nga na ½ të pjesëve ideale.

Po ashtu ka shtuar se në vitin 1975-76 babai i paditësve S. Q nga i padituri i dytë Z. A, në të njejtin vend kishte blerë një paluajtshmëri prej 646m², ndërsa pas matjes në terren është konstatuar se kjo njësi kad. mban numrin ..., në sipërfaqe prej 513,60 m², e cila në ... në Gjilan evidentohet në emër të Z. A dhe Sh. L dhe në bazë të matjeve në teren është konstatuar se kësaj paluajtshmërie i mungon sipërfaqja prej 132.40m². Paditësit në këto paluajtshmëri kanë ndërtuar shtëpitë e tyre si dhe oborret i kanë të rrethuara me mure dhe në shfrytëzimin e tyre deri më tani nuk kanë pasur kurrfarë problemi. Andaj në fund i kanë porpozuar gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktgjykim dhe të aprovohet kërkesëpadija e tyre. Mirpo me parashtrësën e datës 15.08.2018 i autorizuari i paditësve e ka tërhequr pjesërisht padinë edhe ate ndaj të paditurit P. D, ndërsa ndaj të paditurit Sh. L e ka tërhequr padinë vetëm lidhur me njësin kadastrale P-....Gjilan.

Meqë me të paditurën M. B nga Gjilani tani me adresë të panjohur në Zvicërr, gjykata nuk ka mundur të komunikojë edhe pas përpjekjeve të bëra për sigurimin e adresës së saj, është konstatuar që adresa nuk është e saktë, e që këto përpjekje kanë rezultuar pa sukses, andaj duke u bazuar në nenin 79 pika 3, nënpika a) të LPK-ës gjykata vendosi që t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm edhe te avokatin G. S nga Gjilani, ku shpenzimet e të njejtit do t'i bartë paditësi.

Gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, përfaqësuesit të përkohshëm të palës së paditur avokatit G. S nga Gjilani i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, në mënyrë që i njëjti të paraqes përgjigje në padi lidhur me pretendimet e palës paditëse, e që përfaqësuesi i përkohshëm i palës së paditur më datë 02.10.2018 ka ushtruar përgjigje në padi, duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se nga shkresat e lëndës askund nuk ekziston asnjë provë materiale e cila dëshmon se paditësit e kanë blerë paluajtshmërin nga e paditura edhe pse në padi janë theksuar disa prova, andaj mbi këtë bazë i ka porpozuar gjykatës që pas vlerësimi të kësaj përgjigje në padi dhe provave të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës të marr aktgjykim dhe ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Shqyrtimi gjyqësor i datës 10.02.2021, me propozimin e të autorizuarit të paditësit është mbajtur në mungesë së të paditurit Z. A pasi që njëjti ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt dhe mosardhjen e tij nuk e ka arsyetuar, ku i autorizuari i paditësve si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë dhe parashtrësave të dorëzuara në këtë gjykatë duke shtuar se paditësit ngastrën kadastrale me nr... e kanë blerë në vitin 1970 kurse ngastrën kadastrale nr... e kanë blerë në vitin 1975-76, ku në të dyja këto njësi kadastrale kanë ndërtuar dy shtëpi banimi me objekte tjera ndihmëse dhe te dy këto parcela janë të rrethuara me mure. Të njejtit këto paluajtshmëri i

kanë shfrytëzuar pa kurrfarë problemi, mirpo me rastin e tentimit të rregullimit të çështjes së pronësisë është vërtetuar se disa pjesë të këtyre paluajtshmërive evidentohen në emër të fqinjëve. Ka shtuar se i padituri i parë Sh. L edhe në procesverbalet e kësaj gjykata jua ka mohuar paditësve të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri. Po ashtu ka potencuar se edhe me rastin në vend ngjarje është konstatuar se ngastrat katastrale të paditësve, në të gjitha anët janë të rrethaur me mure nga materiali i fortë si tulla të kuqe dhe të betonit.

Po ashtu edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar se lidhur me këto ngastra katastrale paditësit asnjëherë nuk kanë patur asnjë problem me fqinjët dhe se kjo paluajtshmëri, nuk ka qenë e regjistruar në emër të djemëve të tyre kan kuptuar në vitin 2004 pas tërmetit i cili kishte ndodhur në Gjilan, me ç'rast një shtëpi është dëmtuar kur organet komunale i kanë ndarë ndihmat për renovimin e asaj shtëpie dhe pas kësaj paditësit kanë ushtruar kërkesë në Drejtorin e Kadastrit dhe pasi që punëtorët kompetent, të saj kanë bërë matjen në vend të ngjarjes kanë konstatuar se ngastrat kadastrale nr... evidentohen në emër të P. D dhe Sh. L, kurse pjesë e kësaj paluajtshmërie ishte edhe sipërfaqja prej 906 m², në emër të F. S.

Po ashtu edhe dëshmitari M.L i propozuar që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit nga ana e përfaqësuesit të të paditurit F. I mes tjerash ka deklaruar, se të paditurit F. I paluajtshmërin e tij ia ka shitur pra 25-26 viteve dhe se atëherë në mes të kësaj paluajtshmërie dhe paluajtshmërisë së paditësve ka ekzistuar edhe muri rrethues me material të fortë dhe pohon se i padituri F. I nuk ka pasur kurrfarë problemi me paditësit, lidhur me kufirin e paluajtshmërisë së tij. Andaj mbi këtë bazë përfaqësuesi i paditësve i ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia dhe kërkespadija si e bazur dhe vërtetohet se paditësit e kanë fitura të drejtën e pronësisë në bazë të mbajtjes, gjegjësisht parashkrimit fitues konform nenit 28 al.4 të LTHMPJ-së, pasi që të njëjtin me mirëbesim dhe pandërprerë e kanë shfrytëzuar më tepër se 20 vite.

I padituri i parë Sh. L si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se qëndron pranë thnieve nga seancat e kaluara duke shtuar se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve.

I autorizuari i të paditurit F. I av.Ymer Huruglcia si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit kryesor i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar, meqë konsiderojmë që për asnjëherë nga bazat juridike, në të cilat mbështet kjo padi në raport me të paditurin Fatmir Isufi nuk janë vërtetuar. Në të vërtetë i padituri Fatmir Isufi asnjëherë nuk ka pasur raport civilo juridike, qoftë me paditësit apo paraardhësit e tij përkatësisht për pjesën e njësisë së tij në sipërfaqe prej 29m², e që nuk ka qenë objekt i shtiblerjes asnjëherë, që do të thotë që në raport me këtë të paditur, kjo bazë ligjore nuk ekziston. Po ashtu konsideron që nuk ekziston as baza tjetër ligjore, se paditësit të drejtën e pronës në ngastrën kontestuese në raport me të paditurin F. e kanë fituar me parashkrim fitues, përkatësisht me mbajtje, nga fakti se sipas kontratës mbi shitblerjen e ngastrës kadastrale nr... Gjilan me nr.Vr... të dt.13 gusht 2007, i padituri F. është pronar juridik i kësaj ngastre nga viti 2007, prandaj nëse mbështetemi në fitimin e të drejtës me parashkrim fitues qoftë sipas ligjit të vjetër LTHMPJ neni 28, i atij ligji dhe Ligji mbi pronësinë dhe mardhëniet tjera sendore, ligji i ri, neni 40 paragrafi 1 i po atij ligji nga data kur F. është pronar juridik i kësaj ngastre, nuk kanë kaluar 20 vite. Prandaj për të fituar të drejtën e pronësisë në raport me të paditurin F. I me bazën juridik, e mbajte apo parashkrim fitues, me padi është dashtë të përfshihet pronari i mëparshëm H. L, sipas kontratës së lartcekur në bazë të të cilave F. është pronar juridik i kësaj ngastre. Në fund ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit, në raport me F. I si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, duke i specifikuar edhe ato për pengjigje në padi shumën prej 104 € si dhe për të gjitha seancat në të cilat ka prezentuar nga 135€.

I padituri F. S, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se e kudnërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se ngastrës së tij, i janë marrë 97 m², e për të cilat asnjëherë tek ai nuk kanë ardhë paditësit të meren vesh para se të ushtrohet padia, andaj i njëjti konsideron se është më i dëmtuari në këtë çështje dhe i propozon gjykatës që të refuzohet padia dhe kërkespadia e paditësve si e pabazuar, po ashtu ka shtuar se muri i cili është ndërtuar para më shumë se 20 viteve, shton se nuk dihet saktë koha se kur është ndërtuar ky muar. Gjithëashtu i propozon gjykatës që sipërfaqja prej 97 m², të i kthehet ngase i është marrë.

Përfaqësusi i përkohshëm i të paditurës M. B avokati Granit Syllas në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave nga ana e gjykatës sa i përket ngastrës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 26m², nuk është vëreтуar e poashtu nuk ka ekzistuar asnjë raport juridik mes të paditurës dhe paditësve për këtë sipërfaqe kontestuese, andaj në mungesë të një raportit të vlefshëm juridik, i propozon gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkespadia e paditësve N. dhe A. Q.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Çertfiakata pronësore-lista e njësis ...në emër të Sh. L. dhe A Z nga 2/3 respektivisht 1/3 të pjesë ideale të paluajtshmërisë ... Çertfiakta pronësore Ul ... e dt.01.07.2011 në emër të F. I lidhur me parcelën .. Skica e matjeve nga vendi i ngjarjes i dt.28.06.2016 pa vit të caktuar; Çertfiakta e vdekjes me nr.rendor ... të lëshuar në emër të Sh. L të dt.20.12.2013 nga Zara e Gj. C. në Gjilan; Aktvendimi mbi shqyrtimin e trashgëimisë ... dhe T.nr.... e dt.11.04.2014; Ekspertiza er dt.29.06.2016 e inxhienierti B. K. dhe B. D.; Çertfiakta pronësore me nr.të lëndës ... e dt.21.11.2016 që ka të bëjëme njësinë kadastrale ... në meër të F. S; Çertifiakta pronësore me nr.të lëndës ...e dt.21.11.2016 që ka të bëjë me njësin kadastrael ... në emër të M. B e cila sipas shenimeve është bartur lësispas kontratës mbi dhuratën nga F. S, tek M. B si dhe Çertfikata pronësore me nr.të lëndës ... e dt.02.12.2016 lidhur me parcelën P-... në emër të Z. A dhe Sh. L.

F. S i dëgjuar në cilësi të palës në mes tjerash ka deklaruar se prona me nr.... e cila kufizohet me pronën e paditësve juridikisht është e tij, që do të thotë se figuron në emër të tij në librat kadastrale me herët ka qenë arë, ndërsa tani është truall dhe ka të ndërtuar shtëpi ndërsa ai, jeton në një shtëpi tjetër e cila është pak më lart afërsisht 100 metra nga vendi. Kjo pronë që kufizohet me paditësit, prindi i tij e kishte shitur para disa viteve, për afërsisht 30 viteve më parë, emri i blerësit nuk kujtohet ngase nuk kishin përpiluar kurfarë kontrate mbi shitblerjen. Ai nuk e din se sa sipërfaqe të kësaj prone i është shitur personit të cilën tani e shfrytëzon këtë pronë. Prona më parë ka qenë, në emër të prindit të tij e më pas e ka bërë bartjen në emrin e tij para 6 apo 7 viteve. Në momentin kur ishte shitur prona nga babai i tij para 30 viteve, kanë kuptuar se kanë disa probleme rreth sipërfaqes së pronës me paraardhësin e paditësve S. Q. Sa i kujtohe të njëjtit shitës i është shitur vetëm sipërfaqja e mbetur çka do të thotë nuk i është shitur pjesa e cila është në shfrytëzim nga ana e paditësve, e cila pretendon se është e tij. Ka shtuar se nuk kanë filluar asnjë procedurë gjyqësore, lidhur me kthimin e kësaj pjese të kësaj paluajtshmërie. Muri i cili është në pronën e cila është në emër të M. B me nr..., nuk e din se a ka pasur muri të ndërtuar në mes të kësaj prone dhe të pronës së paditësit N. Q.

M. L i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në mes tjerash ka deklaruar se F. I nuk ka blerë pronë nga H. L, por ka blerë pronë nga Z. L, përndryshe babai i tij. Pronën e kishte blerë para 25 - 26 viteve, në të cilën nuk kanë jetuar por vetëm e kanë blerë pastaj e kanë shitur, pronën të cilën babai i tij ia kishte shitur F. e kanë blerë para viteve të 80-ta. Në këtë pronë muk ka pasur

asgjë të ndërtuar, e gjithashtu nuk ka qenë as e rrethuar me asgjë. Prona e cila i është shitur F. I ka qenë 7 ari e 30 metra në momentin kur është shtuar. Padiësit i njeh vetëm sipërfaqësisht, me të cilët nuk kanë pasur asnjëherë ndonjë kontestë pronësor. Ai e din se F. I ka ndërtuar shtëpi në atë pronë dhe tani jeton aty. Ka shtuar se babai i tij njësin kad.nr.... e kishte blerë nga H. /R./ L.a dhe kur e kanë blerë në ngastrën aty afër në pronat e veta kanë qenë edhe padiësit N. e A. Q dhe i kujtohet se ka qenë i ndërtuar një muri me blloka betoni, në mes të ngastrës së Fatmirti dhe padiësit A. Q. Sa i kujtohet të njejtit F. I nuk ka ndonjë problem sa i përket raporteve ndërnjerëzore, me padiësin A.Q në momentin kur është bërë ekspertiza lidhur me këtë çështje kontestimore F. I e ka kuptuar se një pjesë e sipërfaqes së pronës së tij është marrë nga ana e padiësit A. Q, ndërsa pjesa tjetër e cila shtrihet përkaj të rrugës, e që i është marrë F. I e cila edhe shërben si rrugë, F. nuk ishte i interesuar që ta bllokoj rrugën. Ndërsa pjesa e cila i është marrë nga ana e A. Q, F është i interesuar që ta kthej në pronësi të tij. Ka shtuar se nuk e din që F. I, të ketë inicuar ndonjë proces gjyqësor as në të kaluarën e as tani lidhur me kthimin e kësaj pjese të ngastrës-oborrit ku tani jeton, e që i është marrë nga ana e A.Q. Po ashtu ka shtuar se nuk e di se ka pasur ndonjë negociim-biseda në mes të F. dhe padiësve lidhur me këtë çështje të kësaj pjese të sipërfaqes, para se të inicohet kjo procedurë gjyqësore.

S. Q i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në mes tjerash ka deklaruar se parcelën e parë me nr.... në, sipërfaqe prej afër 5 ari e kishte blerë prej Sh. L babai të të paditurit Sh. L, çmimi nuk i kujtohet por e din se ka qenë me dinarë të atëherëshëm jugosllav ashtu që marrëveshja kishte qenë për dy javë dhe mbrenda dy javëve, i ishte paguar çmimi në tërësi. Parcelën e dytë e kishte blerë 4-5 vite pas blerjes së parcelës së parë dhe këtë e kishte blerë prej I. A respektivisht Z. A është djali i tij por që parcela është evidentuar në emër të Z. A dhe sipërfaqja e saj, ka qenë 6 ari e 46m², çmimi i shitblerjes nuk i kujtohet por kjo parcelë është në kufi me parcelën e parë ashtu, që të hollat ia ka dhënë menjëherë por që shpenzimet rreth matjes gjeodezike, i ka paguar ai dhe këtë e kishte matur I. A gjeometër. Në parcelën e dytë kishte ndërtuar shtëpi para luftës, në vitin 2006, e kishte kuptuar që mëxha nuk është në rregull, pasi që ishte bërë termeti në Gjilan . Me rastin e shitblerjes së ktyre dy parcelave, nuk kishte përpiluar kontratë me shkrim, por qe ka paguar çmimin e shitblerjes ashtu që ish pronarët asnjëherë nuk e kishin penguar në shfrytëzimin e qetë të paluajtshmërive, njëren parcelë e kishte mbjellur me pem dhe bashqe dhe tani e gjithë sipërfaqja e dy parcelave është e rrethuar me mure dhe nuk ka asnjë problem me fqinjët, e as me të paditurit.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, dhe nga rezultati i përgjithshëm i procedurës provuese ka si në dispozitiv të këtij asktjykimi.

Objekt i këtij kontesti është pjesa e ngastrës kadastrale ... në vendin e quajtur "P." në sipërfaqe prej 419m², dhe se me rastin e daljes në vend të ngjarjes në bazë të ekspertizës së ekspertit gjeodet u vërtetua se brenda mureve të ngastrës kadastrale ..., ndodhet sipërfaqja prej 26 m², pjesë e ngastrës kadastrale nr.... në emër të të paditurës M. B.

Nga Çertifiakta pronësore-lista e njësisë kad.nr. ..., gjykata vërtetoi faktin se kjo pronë evidentohet në emër të dy bashkëpronarëve edhe atë: Sh. L dhe Ah. Z nga 2/3 respektivisht 1/3, të pjesë ideale të paluajtshmërisë ...

Nga Çertifiakta pronësore UI ...e dt.01.07.2011, gjykata vërtetoi faktin se parcela ..., evidentohet në emër të Fatmir Isufit.

Nga Çertifiakta pronësore me nr.të lëndës ... e dt.21.11.2016 që ka të bëjë me njësinë kadastrale ..., gjykata vërtetoi faktin se kjo pronë evidentohet në emër të M. B.

Gjykata me rastin e këqyrjes në vend ngjarjes ka konstatuar se në parcelat kontestuese janë të ndërtuar pranë njëra tjetrës dy shtëpi banimi në të cilat jetojnë paditësit, kurse oborri është i përbashkët dhe i njëjti është i rrethuar me mure prej betoni dhe blloka te keramikës, te cilat mure sipas paditësve janë ndërtuar nga ana e tyre mirëpo paditësit pretendojnë se jashtë mureve kanë mbetur sipërfaqet e tokës, të cilat ju kanë bashkangjitur ngastrave tjera kadastrale edhe te parcelës nr... dhe parcleës nr..., ashtu që paditësit i mungon një sipërfaqe prej 81 m², respektivisht 145m².

Nga ekspertiza e ekspertit gjeodet e datës 28.02.2019, gjykata vërtetoi faktin se parclea me nr.621-22, në sipërfaqe prej 419m², evidentohet në emër të Z. A me 1/3 dhe Sh.M në distancë 15.7m, në anën perendimore kufizohet me parcleën ... e cila evidentohet në emër të N. (S)Q. në distancë 22.8m, në anën lidore kufizohet me rrugën e cila është e asfaltuar në distancë 25.3 m, në anën jugore kufizohet me parcelën ... cila evidentohet në emër të F. I në distancë 17.4 m, ku në pjesën lindore ku është cekur distanca 1.5m, ka edhe dyert të mëdha të hekurit. Dhe se A.Q sipas gjendjes faktike është duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 29 m², nga parcele ... e cila evidentohet në emër të F. /Q/ I me 1/1 të pjesës ideale dhe se sipërfaqja totale e cila është duke u shfrytëzuar nga A. Q është (419 m²+29m²)=448m².

Deklaratave të këtyre dëshmitarëve, gjykata ua fali besimin e plotë sepse janë objektive dhe në përputhje me gjendjen faktike dhe faktorin kohë, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe se askush nuk ka pasur pretendime rreth të drejtës së pronësisë, e gjithashtu të thënat e tyre ishin në përputhje të plotë me provat e tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Nga gjendja faktike e shpjeguar si më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve ka bazë ligjore dhe të njëjtën e aprovoi, meqë është vërtetuar themelësia e saj ashtu që në bazë të nenit 28 të LTHMPJ-së, të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë kontestuese, ku kjo dispozitë ligjore theksohet se *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”*, e në rastin konkret nga provat e administruara, siç thamë më lartë u vërtetua gjendja faktike se paditësit ngastrat kontestuese i kanë në shfrytëzim me mirëbesim për më tepër se 50 vite, d.m.th. në këtë rast paditësit A. Q dhe N. Q. e kanë ushtruar pushtetin në pronat kontestuese, përkatësisht e kanë poseduar (zotëruar) dhe shfrytëzuar të qetë dhe të pa penguar nga askush që nga viti 1970-1975, në të cilën kanë të ndërtuar edhe dy shtëpi ku të njëjtit jetojnë me familje dhe të papaenguar nga askush, andaj nga të cekurat si më lartë gjykata erdhi në përfundim se paditësit janë mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm të sendit të paluajtshëm dhe se ky pushtet faktik shëndrrohet në pushtet juridik, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv II të këtij aktgjykimi që shpenzimet e procedurës t'i bartin paditësit ashtu që i detyrojnë të njëjtit që për ushtrimin e padisë, tia paguaj shumën prej 156€, për taksë për padi shumën prej 30€, për ekspertiza të gjeodetëve shumën prej 260€, për përfaqësim nga avoaktit për 8 seanca të shtyera në shumë prej 540€ dhe 7 seanca të mbajtur në shumë prej 9450€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,931€, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-ës.

Nga të cekurat më lartë e duke u bazuar në nenet: 28 LTHMPJ-së, 143, 79 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.466/2011 me datë 24.02.2021

Gjyqtari
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apeli. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.